



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr 35, datë 15.03.2026

“PËR PROPOZIMIN E NDRYSHIMIT TË VKM-SË NR. 377, datë 10.7.2025 “PËR TRANSFERIMIN E DISA PRONAVE NË PRONËSI TË BASHKISË KORÇË DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1532, DATË 19.11.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KORÇË, TË QARKUT TË KORÇËS”, TË NDRYSHUAR”

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Pergjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore bazuar në nenin nenet 23 pika 14 dhe nenin 54 gërma të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit nr.8744 datë 22.01.2001” Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar si dhe mbas diskutimeve të këshilltarëve:

VENDOSI:

1. Të propozojë ndryshimin e VKM-së nr. 377, datë 10.7.2025 “Për transferimin e disa pronave në pronësi të bashkisë korçë dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 1532, datë 19.11.2008, të këshillit të ministrave, “për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Korçë, të Qarkut të Korçës”, të ndryshuar për heqjen e kufizimit për ndalimin e tjetërsimit të pronave përcaktuar në këtë VKM.
2. Të propozojë heqjen e kufizimit, për ndalimin e tjetërsimit të pasurive me numër rendor si më poshtë:

Numri rendor i pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronave	Lloji i transferimit të pronave
966, 968	Strehim dhe ndërtim banesa sociale	Në pronësi
967	Administratë	Në pronësi
969	Zhvillim ekonomik	Në pronësi

3. Qëllimi i këtij ndryshimi është për mundësimin e përdorimit ose tjetërsimit të tyre në funksion të interesit publik dhe zhvillimit të mëtejshëm.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore .

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 24 vota

Vota Pro 24

Vota Kundër 3

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 13-03-2026

KRYETAR

